

V E N D I M
Nr.7, datë 14.9.1994

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani,	Zv/kryetar	i ""
Hilmi Dakli,	Anëtar	i ""
Veli Budo,	Anëtar	i ""
Natasha Sheshi,	Anëtare	e ""
Thimjo Kondi	Anëtar	i ""
Franc Jakova,	Anëtar	i ""
Ylvi Myrtja,	Anëtar	i ""

me sekretare Drita Filto, më datën 30.5.1994 dhe 14.9.1994, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.10 që i përket :

K Ë R K U E S E : SHOQATA KOMBËTARE E TË SHPRONËSUARVE “PRONËSI ME DREJTËSI”, e përfaqësuar nga kryetari i saj Rrapo Danushi si dhe nga zotërinjtë Xhavit Turkeshi e Abedin Peza.

O B J E K T I :

Shfuqizimin e ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën”, ligjit nr.7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”, si edhe shfuqizimin e neneve 5, 12, 13, 14, 17, 19, 23, 25 e 26 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N :

I. Rregullimet e bëra me ligjin nr.7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën” dhe me shtojcat e tij të mëvonshme, si edhe me ligjin nr.7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”, kanë tiparet e një reforme agrare të mbështetur në parimin e drejtësisë shoqërore, i cili përcaktohet në nenin 2, paragrafi 2, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Kjo i shërben realizimit të programit të shtetit tonë të së drejtës për vetëshpronësimin e tij dhe privatizimin e ekonomisë. Në këtë paketë ligjesh, synohet që qëllimet e lartpërmendura të gjejnë zbatim në harmoni me kushtet historike e aktuale të Shqipërisë.

Në bazë të nenit 18 të Kushtetutës, që shteti diktatorial komunist kishte miratuar më 28.12.1976, toka bujqësore dhe të gjitha llojet e tjera të tokave u bënë, edhe “de jure”, pronë ekskluzive e atij shteti. Si rrjedhim, bujku dhe blegtori jo vetëm që nuk kishin në pronësi asnjë pëllëmbë toke, por ishin të detyruar të punonin në kooperativë bujqësore ose në ndërmarrje bujqësore shtetërore, ku përfshihej fshati i vendbanimit të tij.

Edhe sot rreth 65 % e popullsisë sonë vazhdon të jetojë në fshat, duke u marrë me bujqësi e blegtori, ndërsa trashëgimtarët e pronarëve të dikurshëm, që kanë banuar e banojnë në qytete të ndryshme prej jo më pak se gjysëm shekulli e këtij objektivisht nuk kanë pasur asnjë lidhje ekonomike me fshatin ku ndodhen ato toka.

Sipas nenit 8 të ligjit nr.7699, datë 23.4.1993, ish-pronarët e lartpërmendur të tokave bujqësore përfitojnë kompensim të plotë në vlerë për sipërfaqen deri në 15 hektarë. Kompensimi në vlerë për pjesën tjetër të ngastrave, që kapërcejnë sasinë prej 15 hektarë, u jepet ish-pronarëve sipas koeficienteve të përcaktuar në këtë dispozitë. Gjithësesi, shuma maksimale e kompensimit në vlerë nuk mund të jetë në asnjë rast më e madhe se ekuivalenti i një sipërfaqeje prej 43.5 hektarë.

Nga përmbajtja e nenit 10 të këtij ligji rezulton qartë se kompensimi në vlerë jepet vetëm nëpërmjet obligacioneve shtetërore të emetuara në lekë, të cilat pronari përkatës lejohet t’ua shesë

personave të tretë, sipas çmimit të caktuar lirisht nga vetë palët, ose t'i transferojë me anë veprimesh juridike të tjera të ligjshme.

Këto obligacione, sikurse është përcaktuar në dispozitën e lartpërmendur, janë tituj shtetërorë të garantuar dhe i japin titullarit përkatës të drejtën e parablerjes në rastet kur vihen në shitje objekte të veçanta të pronës shtetërore, siç janë objekte industriale, troje ndërtimi, ngastra toke e aksione të ndërmarrjeve shtetërore. Veç kësaj, shteti është i detyruar që këto obligacione t'i shlyejë, nëpërmjet pasurisë shtetërore, deri më 31.12.1999. Pas këtij afati, gjatë një periudhe jo më tepër se pesëvjeçare, kjo shlyerje mund të bëhet edhe drejtpërdrejt me lekë.

Gjykata Kushtetuese, duke u mbështetur në të dhënat e mbledhura dhe në përmbajtjen e ligjit, çmon se janë të pabazuara pretendimet e Shoqatës Kombëtare "Pronësi me Drejtësi".

1. Pretendohet se "Ky regjim juridik i tokave bujqësore, që është caktuar me ligjet antikushtetuese të lartpërmendura, nuk ka asnjë precedent në praktikën ligjvënëse të vendeve demokratike e madje është më komunist se ligji "Mbi reformën agrare" i miratuar nga shteti diktatorial i Enver Hoxhës".

Përmbajtja e këtyre pretendimeve tregon se drejtuesit e kësaj Shoqate nuk kanë parasysh që sistemi i kompensimit nëpërmjet obligacioneve shtetërore, edhe për ish-pronarët e tokave bujqësore, është parashikuar shprehimisht në legjislacionet e disa shteteve demokratike europiane, të cilët janë krijuar pas shëmbjes së sistemit totalitar komunist, ndonëse ata kanë një zonë fushore e kodrinore të ulët shumë më të madhe nga ajo e vendit tonë, vështuar edhe përpjesëtimisht me numrin e popullsisë. Gjithashtu, përfaqësuesit e kësaj Shoqate nuk kanë patur parasysh se reforma agrare e regjimit totalitar komunist u zbatua në Shqipëri pa asnjë lloj kundërshtërimi, sepse edhe ato sasi krejt të pakta toke, që iu njohën disa pronarëve të vegjël jo bujqër me ligjin nr.108, datë 29.8.1945, u morën faktikisht me vendime të komisioneve për zbatimin e reformës agrare pranë komiteteve ekzekutive të nënprefekturave përkatëse qysh në vitin 1945, ndërsa me ligjin datë 27.5.1946, u mohua tërësisht edhe "de jure" pronësia e personave të lartpërmendur mbi çdo sasi toke bujqësore.

2. Pretendohet se "Nuk bëhet asnjë dallim në shpronësimin ndërmjet tokës arë dhe kategorive të tjera të tokës bujqësore (ullishta, vreshta, pemishte, kopshte, pyje e kullota), ndonëse dihet se reformës agrare në vendet demokratike i është nënshtruar vetëm toka arë. Madje ligjet për këtë reformë agrare janë miratuar pa marrë parapakisht mendimin e pronarit dhe pa i dhënë menjëherë shpërblimin përkatës".

Ky pretendim nuk i përgjigjet realitetit, sepse për sa u përket rrënjëve të ullinjve, vreshtave, pemishteve e aq më tepër kopshteve, ato kudo u janë dhënë nga reforma agrare bujqut përfitues në rastet kur faktikisht përfshihen brenda sipërfaqes së ngastrave përkatëse. Kriteri i kundërt do të vështirësonte kushtet e jetesës së familjes bujqësore dhe do të krijonte një bashkëpronësi vërtetë joracionale. Pikërisht për këto arsye ky kriter ka qenë zbatuar edhe nga reforma agrare e ngushtë që ndërmori shteti monarkik zogist.

Përsa u përket pyjeve dhe kullotave duhet theksuar se në nenin 793, paragrafi 2, të Kodit Civil të Shqipërisë të vitit 1929, thuhet tekstualisht: "Pyjet dhe kullotat komunale, për të cilat bahet fjalë në ligjën e pyjeve, janë të patjetërsueshme dhe u shtrohen rregullave të caktueme në të". Pra, kjo kategori pyjesh e kullotash ishte pronë ekskluzive shtetërore (komunale), ishte e patjetërsueshme dhe shërbente vetëm për plotësimin e nevojave përkatëse të familjeve bujqësore e blegtorale të secilit fshat, që përfshihej në territorin e komunës respektive si edhe për përmbushjen e ndonjë nevoje tjetër të karakterit komunal. Në zbatim të kësaj dispozite, praktika gjyqësore shqiptare, gjatë viteve kur ishte në fuqi ai Kod Civil, i ka konsideruar të pavlefshme (nul) tapitë arbitrare në bazë të të cilave ndonjë çifligar pretendonte të drejta pronësie mbi ndonjë kullotë a pjesë pylli komunal.

Edhe shumica e pyjeve dhe kullotave me rëndësi kombëtare (dmth jo të kategorisë komunale), sikurse vërtetohet nga të dhënat dokumentare përkatëse, kanë qenë, sipas legjislacionit shqiptar të periudhës para vendosjes së diktaturës komuniste, pronë e shtetit, ndërsa pronësia private mbi ndonjë objekt të tillë ka qenë një dukuri e rrallë.

I pabazuar është edhe pretendimi vijues i kësaj Shoqate se, para miratimit të paketës së ligjeve të lartpërmendura, organet kompetente du

bujqësore sipas parimeve të drejtësisë shoqërore dhe të ligjeve objektive të ekonomisë së tregut.

3. Pretendohet se “Në disa zona sidomos të veriut mbi

65 % e tokës bujqësore është ndarë nga vetë fshatarët sipas kufijve legjitimë të vjetër dhe jo sipas dispozitave të ligjit në fuqi, fakt ky që ka çuar në një gjendje juridike paradoksale e antikushtetuese”.

Ky pretendim nuk i përgjigjet besnikërisht realitetit. Nga të dhënat, që shqyrtuam në drejtorinë kompetente të Ministrisë së Bujqësisë, rezulton para së gjithash se përqindja e lartpërmendur paraqitet mjaft më e vogël. Gjithashtu përmbajtja e disa raporteve studimore, që disponon Departamenti i Burimeve Natyrore pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, vërteton se metoda e shpërndarjes së tokave bujqësore sipas kufijve të vjetër nuk është penguar nga drejtuesit e komunave dhe rretheve kompetente në rastet kur kjo metodë e shpërndarjes është zgjedhur e miratuar nga bujqët e fshatit përkatës. Përkundrazi, organet e lartpërmendura kanë kryer veprimet e nevojshme për parandalimin ose mënjanimin e pushtimeve me dhunë të tokave bujqësore.

Ky qëndrim nuk është i kundërligjshëm e, aq më pak antikushtetues, sepse legjislacioni ynë vazhdon të ndalojë (vetëkuptohet për një hark kohor jo të gjatë) shitjen dhe blerjen e ngastrave të tokës bujqësore (neni 2 i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991), por jo edhe shkëmbimin e tyre me vullnetin e lirë të pronarëve të tanishëm.

Nga evidenca e shpërndarjes së tokës deri më datë 15.6.1994" (kopja e së cilës ndodhet e bashkëlidhur në këtë dosje) si edhe nga deklaratat e ministrit të Bujqësisë që janë botuar gjatë të njëjtit muaj nga disa organe të shtypit rezulton se deri në atë datë iu ishin shpërndarë familjeve bujqësore, në shkallë vendi, pothuaj 95 % tokë, duke përfshirë edhe 20.000 (njëzetmijë) hektarë nga të atyre ndërmarrjeve bujqësore që janë futur në privatizim.

Pra, një pjesë e konsiderueshme e familjeve bujqësore ka rreth dy vjet, që po e gëzon tokën e vet të fituar me ligj. Si rrjedhim, do të cenohej parimi kushtetues i drejtësisë shoqërore në rast se do të pranohej pretendimi që tokën bujqësore që ka marrë në bazë të ligjit të lartpërmendur, fshatari të mos e ketë në pronësi, por ta ketë vetëm në përdorim duke i paguar qiranë ish-pronarit.

4. Pretendohet se, “Falja e tokave të pronarëve vendas bujqve me kombësi të huaj është një akt pa precedent në legjislacionin dhe praktikën shtetërore botërore. Aq më tepër që këta bujq përbëjnë një entitet në kufi me shtetin, kombit të të cilit i përkasin, përfaqëson një kërcënim serioz për integritetin tokësor të Shtetit Shqiptar në të ardhmen”.

Lidhur me këtë pretendim është, para së gjithash, e domosdoshme të theksohet se në shumë vende të Europës banojnë familje bujqësore, që përbëjnë një pakicë kombëtare kompakte në kufirin politik me shtetin e kombit të cilit i përkasin, e megjithatë atyre nuk u është mohuar e drejta për të patur në pronësi toka bujqësore.

Pretendimi i lartpërmendur, që ka parashtruar Shoqata Kombëtare “Pronësi me Drejtësi”, vjen në kundërshtim me dispozitat të ligjeve kushtetuese të Republikës së Shqipërisë si edhe me përmbajtjen e një sërë akteve ndërkombëtare të gjithëpranura.

Kështu në nenin 2, paragrafi 2, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” është parashikuar shprehimisht barazia e shtetasve para ligjit, ndërsa në nenin 4 të tij është sanksionuar se “Republika e Shqipërisë njeh dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe të pakicave kombëtare, që janë pranuar në dokumentet ndërkombëtare”. Edhe në nenin 25 të ligjit kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” është sanksionuar se : “Të gjithë janë të barabartë në ligj e para ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet për shkak të racës ose të etnisë...”, ndërsa në nenin 26 është përcaktuar, ndër të tjera, se “Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë të ushtrojnë, pa asnjë lloj diskriminimi dhe në barazi para ligjit, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut...”.

Jo vetëm legjislacioni, por edhe realiteti i përditshëm ka vërtetuar pamëdyshje se Republika e Shqipërisë, duke qenë shtet demokratik dhe

minoriteteve, që jetojnë në territorin e tij. Veçanërisht domethënëse është Deklarata e Shtetit Shqiptar para Lidhjes së Kombeve “Mbi mbrojtjen e pakicave kombëtare në Shqipëri”, që u nënshkrua në Gjenevë më 2.10.1921 dhe u regjistrua në Sekretariatin e Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve më 22.3.1922 (botuar në volumn IX, fq.174 të “Recueil des Traites” të Lidhjes së Kombeve). Disa akte noteriale të viteve 1921-1939 vërtetojnë se pronarë shqiptarë u kanë shitur ndonjë familjeje bujqësore të minoritetit grek jo vetëm troje për ndërtim shtëpie, por edhe ndonjë ngastër toke bujqësore.

II. Shoqata Kombëtare “Pronësi me Drejtësi”, ka pretenduar, që të shpallen antikushtetuese edhe disa nene të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, e konkretisht :

1. Neni 5 ku thuhet se “Në të gjitha rastet kur nuk përcaktohet ndryshe në këtë ligj, masa e kthimit ose e kompensimit për trojet do të jetë e plotë deri në 10.000 m²” (dmth deri në dhjetë dynym). Kur prona është nga 10.000 deri 100.000 m², masa e kthimit do të jetë plus 10 përqind...”.

Përfaqësuesit e kësaj Shoqate parashtruan në seancë gjyqësore, se kjo dispozitë është antikushtetuese, sepse, në bazë të nenit 27 të ligjit kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, duhet t’i kthehet pronarit e gjithë sasia e truallit, pavarësisht nga madhësia e tij mbi 10.000 m², dhe, në pamundësi objektive t’i kompensohet gjithë vlera përkatëse. Ky pretendim nuk është i pranueshëm. Është e vërtetë se neni 27 i ligjit kushtetues të lartpërmendur përcakton se shpronësimi mund të bëhet vetëm për një interes publik dhe kundrejt shpërblimit të plotë të vlerës së objektit që shpronësohet. Mirëpo, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë aspak me ndonjë shpronësim të kryer nga shteti aktual demokratik e juridik shqiptar, por, përkundrazi, me ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” ky shtet, ndonëse nuk ishte dhe as mund të ishte përgjegjës për pronat e shtetëzuara, të konfiskuara, të shpronësuara ose të marra arbitrarisht në çdo mënyrë tjetër nga shteti diktatorial komunist, mori përsipër detyrimin ligjor për të riparuar, brenda mundësive objektive, këto lloje padrejtësish të kryera pas datës 29.11.1944 e deri në shembjen e shtetit monist. Por, sikurse thuhet në nenin 1 të këtij ligji, kthimi ose kompensimi i atyre pronave do të bëhet sipas mënyrave dhe masave të përcaktuara nga ky ligj.

2. Neni 13 , i cili ka këtë përmbajtje:

“Kur në objektin ish-pronë private janë kryer nga shteti apo personi blerës shpenzime për ndryshime në strukturën, shtesa anësore apo shtesa kati etj., objekti i kthehet ish-pronarit pa kundërshtim në qoftë se vlera e shpenzimeve përbën deri 20 % të vlerës së objektit. Kur në objektin ish-pronë private vlefte e shpenzimeve të kryera përbën mbi 20 e deri në 50 % të vlerës së objektit, ai mund të kalojë në pronësi të ish-pronarit, pasi të jetë shlyer nga ana e tij kundërvlefte e lartpërmendur, mbi 20 %, e llogaritur mbi bazën e çmimeve të ndërtimit në kohën e rikthimit të pronës. Kur vlefte e shpenzimeve të kryera është mbi 50 % të vlerës së objektit, ky i fundit mbetet në bashkëpronësi”.

Këta dy paragrafë të këtij neni nuk përmbajnë ndonjë mospajtim me dispozita kushtetuese në fuqi.

Paragrafi 1 i nenit 13 i favorizon ish-pronarët, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni, duke i ngarkuar ish-pronarit detyrimin për të paguar shpenzimet e sipërsënuara që shkojnë nga 21 deri 50 % të vlerës së ndërtesës, si edhe duke përcaktuar bashkëpronësinë kur asaj ndërtese i janë bërë shtesa kati ose anësore, të cilat kapërcejnë masën 50 % të vlerës totale të saj, jo vetëm që nuk vjen në kundërshtim me ndonjë dispozitë kushtetuese, por pajtohet plotësisht me dispozitat përkatëse të çdo legjislacioni civil, të cilat ndalojnë përfitimet pasurore të papërligjura.

Nuk janë antikushtetues as paragrafët 3 e 4 të këtij neni, të cilët përcaktojnë se kthimi i pronave ish-pronarëve bëhet në përshtatje me normat shtetërore të mirëmbajtjes dhe përdorimit të ndërtesave, se vlerësimi i dëmtimeve, që i janë shkaktuar çdo objekti të paluajtshëm të tillë, kryhet nëpërmjet ekspertësh, se

edhe strehimin e qiramarrësve të sotëm, duke u dhënë përparësi familjeve me të ardhura të pakta financiare.

Këtej konkludohet se përmbajtja e këtij neni pajtohet plotësisht me dispozitat kushtetuese në fuqi të Republikës së Shqipërisë, që sanksionojnë parimin e drejtësisë sociale. Përkundrazi, do të ishte një zgjidhje antikushtetuese dorëzimi menjëherë pronarit i ndërtesës së banimit, duke i lënë qiramarrësit e ligjshëm e me mirëbesim pa strehim.

4. Neni 19, ku përcaktohet se trojet e lira, brenda vijave kufizuese të qyteteve dhe të zonave turistike, do t'u kthehen ish-pronarëve duke u zbatuar këto kritere : a) 5.000 m² truall ndërsa pjesa tjetër do t'u kompensohet sipas mënyrave të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji (dmth nëpërmjet obligacioneve shtetërore, sipërfaqeve të trojeve ekuivalente deri 5.000 m² pranë qendrave të banuara ose zonave turistike); b) 5.000 m² për tokat bujqësore, që janë përfshirë brenda vijës së verdhë të qytetit përkatës ose brenda perimetrit të zonës turistike, ndërsa pjesa tjetër do të kompensohet nëpërmjet obligacioneve shtetërore.

Përmbajtja e këtij neni nuk vjen në kundërshtim me asnjë dispozitë kushtetuese dhe madje pajtohet plotësisht me nenin 1 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 ku thuhet, ndër të tjera, se ky ligj përcakton mënyrat dhe masat për kthimin apo kompensimin e pronave ish-pronarëve.

5. Neni 23, i cili ka tekstualisht vetëm këtë formulim : “Nuk trajtohen me këtë ligj pronat e ish-mbretit dhe e shoqërive të huaja ose të përbashkëta”.

Është fakt i njohur se nuk mund të cilësohet antikushtetuese një dispozitë ligjore, e cila përcakton që një marrëdhënie pasurore e caktuar, për shkak të vetë natyrës specifike të saj, të mos rregullohet nga ligji në të cilin është përfshirë ajo dispozitë, por me një ligj tjetër.

6. Neni 25 nuk është antikushtetues dhe këtë e vërteton vetë përmbajtja e tij, e cila është tekstualisht si vijon : “Pranë Këshillit të Ministrave krijohet Komisioni Shtetëror i Kthimit ose Kompensimit të Pronave të Ish-Pronarëve për evidentimin e pretendimeve të tyre, që nuk kanë gjetur zgjidhje në këtë ligj”.

7. Gjithashtu nuk është antikushtetues neni 26, i cili përbëhet vetëm nga kjo fjali : “Çmimi i truallit caktohet me ligj të veçantë”. Natyrisht kjo dispozitë i referohet vetëm çmimit të truallit, që do t'i kompensohet ish-pronarit në kushtet e Ligjit Nr.7698, datë 15.4.1993.

Përsa u përket nenit 12, paragrafi 1 dhe nenit 17 të këtij ligji, ata janë shpallur antikushtetues me Vendimin Nr.4, datë 8.4.1994 të kësaj Gjykate, i cili është i formës së prerë dhe ka fuqinë e gjësë së gjykuar.

Pretendimi i kësaj Shoqate se në këtë ligj nuk është parashikuar që të kompensohet vlera e godinave të shembura e të pashpërblyera nga shteti i diktaturës nuk mund të zgjidhet nga Gjykata Kushtetuese, sepse, siç dihet, kjo nuk është organ ligjvënës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24/2 dhe 27 të ligjit kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992, njëzëri,

V E N D O S I :

Rrëzimin e kërkesës së Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”.
Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Tiranë, më 14.9.1994